LIGJ
Nr.10 377, datë 10.2.2011

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 1, DATË 26.1.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT TË ZHVILLOJË PROCEDURËN E PROKURIMIT ME NEGOCIM, PA SHPALLJE PARAPRAKE TË NJOFTIMIT, PËR OBJEKTET E MBROJTJES NGA PËRMBYTJA DHE TË KULLIMIT NË ZONËN E SHKODRËS E TË LEZHËS, TË PLANIFIKUARA NË BUXHETIN E VITIT 2011"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr.1, datë 26.1.2011 i Këshillit të Ministrave "Për lejimin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të zhvillojë procedurën e prokurimit me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit, për objektet e mbrojtjes nga përmbytja dhe të kullimit në zonën e Shkodrës e të Lezhës, të planifikuara në buxhetin e vitit 2011".

Shpallur me dekretin nr.6905, datë 22.2.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi